

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e praktikantes Besjana Çollaku, në çështjen penale të akuzuarit E.A nga Prishtina, për shkak të veprës penale arratisja e personit të privuar nga liria nga neni 405 par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.711/2014 të datës 14.04.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në praninë e prokurorit shtetit Mehreme Hoxha dhe të akuzuarit, me datë 20.11.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**E.A** nga i ati I.. dhe e ëma A.. e lindur ..., i lindur me datë ... në Prishtinë, ku edhe tani jeton në rrugën “...” pa nr., ka të kryer shkollën e mesme, student pranë fakultetit Filozofik në Prishtinë në katedrën e filozofisë, i pa martuar, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

Në kuptim të nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPPK.

**L I R O H E T N G A A K U Z A**

Me datë 19.03.2014 rreth orës 13:30 minuta, në Prizren, saktësisht në Stacionin Policor arratiset nga institucioni ku gjendej në mbajtje, në bazë të vendimit të ligjshëm mbi privimin na liria, në atë mënyrë derisa qëndronte i arrestuar për shkak të prishjes së rendit dhe qetësisë publike i cili qëndronte në lokalet e Stacionin Policor, pa u konsultuar me zyrtar policor, largohet nga lokalet e institucionit.

**Këso dore kishte për të kryer veprën penale arratisja e personit të privuar nga liria nga neni 405 par.1 të KPK.**

Për shkak se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.711/2014 të datës 14.04.2014, kundër të akuzuarit E.A nga Prishtina, për shkak të veprës penale arratisja e personit të privuar nga liria nga neni 405 par.1 të KPK.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit Mehreme Hoxha ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar nën numrin PP/II.nr.711/2014 të datës 14.04.2014, kundër të akuzuarit E.A, për shkak të veprës penale arratisja e personit të privuar nga liria nga neni 405 par.1 të KPK. Andaj i propozoi gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, po ashtu

propozoi gjykatës me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të merr parasysht të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në dënim.

Në fjalën përfundimtare i akuzuari E.A theksoj se nuk e ndjen veten fajtor për veprën penale me të cilën ngarkohet, sepse veprimin që ka ndërmarrë ditën kritike tregon pa përgjegjësinë e organeve të rendit dhe nuk tregon ndonjë rrezik të mundshëm nga ai. Po ashtu theksoj se dënimi ndaj tij për shkak të pjesëmarrjes në protesta kundër kryetarit të Komunës së Prizrenit është thellësisht i padrejtë, pasi që qëllimi i tij nuk ka qenë që ta lëndoj dikë e as të pengoj zyrtarët gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, pasi që qëndrimi i tij ideologjik dhe politik është i ndarë nga veprimet e tij, të cilat ndoshta dikush e konsideron si veprime inkriminuese. I akuzuari qëndrimin e tij e arsyeton se nuk ka pasur qëllim që të arratiset ashtu siç thirret aktakuza, me ç'rast edhe është bërë cilësimi juridik në aktakuzë, por potencon se ai ka qenë plotësisht i pa informuar se një veprim i tillë është vepër penale. Po të kishte pasur qëllim të tillë siç thirret aktakuza, i akuzuari është ndalur dhe arrestuar shumë herë nga zyrtarët policor, por asnjëherë nuk është arratisur. Andaj nga gjykata kërkoi që të shqipton aktgjykim lirues, pasi që në veprimet e tij nuk formohen elementet e veprës penale, arratisja e personit të privuar nga liria nga neni 405 par.1 të KPK.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat e propozuara nga ana e prokurorit të shtetit, me ç'rast edhe është bërë leximi i provave materiale dhe atë: raporti i oficerit me numër të rastit 2014-GA-0763 të datës 19.03.2014, raporti i oficerit pa numër të rastit të datës 19.03.2014 përpiluar në ora 17:50 minuta, raporti i oficerit me numër të rastit 2014-GA-0783 të datës 20.03.2014, deklarata e akuzuarit E.A dhënë para prokurorit të shtetit me numër PP/II.nr.711/2014 të datës 22.03.2014 dhe raporti për fillimin e procedurës për kundërvajtje me numër 2014-GA-0763 të datës 19.03.2014.

Vlen të theksohet se gjykata duke e analizuar provat veç e veç dhe lidhmërinë e provave në tërësi, gjeti se të gjitha provat e arsyetojnë se në veprimet e akuzuarit E.A, nuk formohen elementet genësore të veprës penale arratisja e personit të privuar nga liria nga neni 405 par.1 KPK. Sipas qëndrimit të gjykatës gjatë procedurës së provave nuk është vërtetuar se ditën kritike i akuzuari është larguar nga zyra e Stacionit Policor në Prizren, i cili ishte ndalur me aktvendim - mbi ndalimin e personit të arrestuar, pasi që në rastin konkret nuk ka pasur vendim të ligjshëm mbi privimin nga liria të akuzuarit, me të cilin është dashur të qëndroj në lokalet e institucionit ku ishte i ndaluar. Pra nga provat e administruara gjykata nuk ka mundur të vërtetoj se ndaj të akuzuarit pasi që është ndalur nga zyrtarët policor është shqiptuar një vendim i ligjshëm dhe atë nga organi kompetent mbi ndalimin e të akuzuarit E.A, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale, element kryesor që lidhet drejtpërdrejtë me elementet tjera në figurën e veprës penale arratisja e personit të privuar nga liria nga neni 405 par.1 të KPK, me të cilën ngarkohet i akuzuari, në pajtim me dispozitat e KPK.

Gjykata ka analizuar mbrojtjen e akuzuarit dhe të njëjtën ka pranuar në pjesën nga e cila del se ditën kritike me datë 19.03.2014 rreth orës 13:30 minuta në Prizren, i akuzuari E.A si aktivist i Lëvizjes VetëVendosje, ka protestuar kundër kryetarit të Komunës së Prizrenit dhe atë para ndërtesës së Kuvendit Komunal – para “Shtëpisë së Bardhë”. Në këtë protestë si aktivist ka ardhur nga Prishtina, sipas organizimit të partisë së cilës i takon. Derisa ka qëndruar në mesin e protestuesve nuk ka ushtruar dhunë e as që ka penguar zyrtarët policor në kryerjen e detyrave të punës, por përkundrazi ka qenë shumë i qetë, pasi që qëndrimi i subjektit të cilës i takon ka pasur këtë direktivë. Po ashtu i akuzuari theksoj se derisa ka qëndruar në protesta ai është shoqëruar në stacion policor nga ana e zyrtarëve të policisë, të cilët kanë lënë vetëm në një dhomë të vogël, për të cilën mendon se ajo ka qenë një zyre që i takonte stacionit policor. Aty ka qëndruar disa minuta,

pastaj ka dal nga aty pa u penguar nga askush dhe pa e ditur se veprim i tij qenka shkelje që bie ndesh me dispozitat e Kodit Penale të Kosovës. Kjo pjesë e mbrojtjes mbështetet edhe në provat materiale të cilat gjykata ka administruar në procedurën e provave siç janë: raporti i oficerit me numër të rastit 2014-GA-0763 të datës 19.03.2014 dhe raporti i oficerit pa numër të rastit të datës 19.03.2014, përpiluar në ora 17:50 minuta, në të cilat raporte përshkruhet situata dhe atë momenti kurrë dhe si është shoqëruar i akuzuari deri në stacionin policor. Në këto raportet bëhet përshkrimi i veprimeve të zyrtarëve policor të cilët kanë shoqëruar protestuesit në mesin e të cilëve ka qenë edhe i akuzuari E.A, këto prova dhe përmbajtja e këtyre provave janë plotësisht në pajtim me deklaratën e akuzuarit. Por nga këto prova nuk del se ndaj të akuzuarit është marrë një vendim i ligjshëm mbi privimin nga liria. Po ashtu në mbrojtjen e tij i akuzuari ka përshkruar edhe mënyrën se si ka qëndruar dhe si ka dal nga zyra e Stacionit Policor në Prizren. Sepse i akuzuari pasi që ishte vetëm nga kjo zyrë ka dal qetë dhe pa u penguar nga askush, më pas ka dal në korridor i cili ka pasur paketën e duhanit në dorë me qëllim që ta konsumoj duhan, pasi që në ndërtesë brenda ishte e ndaluar pirja e duhanit. Mirëpo i akuzuari pasi që nuk është penguar nga askush ka vazhduar rrugën dhe del jashtë objektit të stacionit policor, i bindur në veprimet e veta kur sheh se nuk pengohet nga zyrtarët policor, shkon përsëri në drejtim të pjesës së qytetit me qëllim që të bashkohet me protestuesit.

Gjithashtu gjatë analizës së provave dhe rrethanave të rëndësishme në rastin konkret siç janë: raporti me numër të rastit 2014-GA-0763 të datës 19.03.2014, raporti pa numër të rastit të datës 19.03.2014, përpiluar në ora 17:50 minuta, raporti me numër të rastit 2014-GA-0783 të datës 20.03.2014, gjykata ka vërtetuar se në këto prova bëhet përshkrimi i momentit se çfarë veprime kanë ndërmarre në kuadër të detyrave zyrtarët policor – konkretisht si është bërë mbrojtja e perimetrit në zonën e qytetit ku është ndërtesa e Kuvendit Komunal Prizren – ndërtesa ku është zyra e kryetarit të Komunës së Prizrenit. Në këto raporte të cilat janë përdorur si prova përshkruhet mënyra se si është dhënë rezistencë zyrtarëve të policisë nga ana e protestuesve dhe masat të cilat janë ndërmarrë nga ana e tyre dhe transportimi i protestuesve në mesin e të cilëve ka qenë edhe i akuzuari E.A. Po ashtu vlen të theksohet se nga këto prova gjykata nuk ka vërtetuar se i akuzuari ditën kritike është larguar nga stacioni policor me dhunë apo me ndonjë veprim të paligjshëm, pasi që sipas raporteve në objektin e Stacionit Policor, kanë qenë të pranishëm zyrtarët policor në detyrë të cilët protestuesit – konkretisht të akuzuarin E.A kanë akomoduar në një zyrë dhe kanë vepruar në bazë të vendimit të ligjshëm mbi privimin nga liria. Përfundimisht, sipas qëndrimit të gjykatës me asnjë provë nuk është vërtetuar se veprimet e të akuzuarit E.A, që do të ishte në pajtim me figurën e veprës penale e cila do të vërtetonte elementin subjektiv – përgjegjësin penale të akuzuarit, ku vjen në shprehje parimi i ligjshmërisë e cila përcakton se personi është përgjegjës për veprimet e veta, nëse veprën penale e ka kryer me dashje, në rastin konkret i akuzuari të ketë larguar me qëllim të arratisjes - shmangies nga zyrtarët e Stacionit Policor, që do të konsiderohej se ka bërë veprim të kundërligjshëm që të arratiset nga institucioni në të cilën është në ndalim me vendim të ligjshëm. Në rastin konkret ky fakt nuk është vërtetuar sepse ajo që mund të thuhet pa mëdyshje është se i akuzuari nuk ka pasur **“një vendim të ligjshëm”** me të cilin do të njoftohej mbi arrestimin e tij nga ana e zyrtarëve të policisë, për dyshimin e bazuar se i njëjti ka kryer një vepër penale, lëshuar nga zyrtarët kompetent, i cili fakt është njëri nga elementet e veprës penale arratisja e personit të privuar nga liria nga neni 405 par.1 të KPK, por i akuzuari në mungesë të vendimit ka dal qetas nga zyra e stacionit policor. Gjykata duke u nisur nga ky fakt dhe nga provat të cilat në asnjë mënyrë nuk kanë vërtetuar fakte vendimtare për të vërtetuar çfarëdo veprimi inkriminues të cilat janë ndërmarrë nga ana e akuzuarit, por përkundrazi ka forcuar bindjen se në veprimet e akuzuarit nuk formohen elementet e veprës penale arratisja e personit të privuar nga liria nga neni 405 par.1 KPK. Këto rrethana dhe fakte lidhur me ngjarjen që kishte ndodhur ditën kritike janë vërtetuar edhe nga

deklarata e akuzuarit E.A, dhënë para prokurorit të shtetit në procesverbalin numër PP/II.nr.711/2014 të datës 22.03.2014, ku i akuzuari e pohon faktin se ditën kritike është shoqëruar nga ana e zyrtarëve policor, për pjesëmarrjen në protestat, ku edhe është dërguar në lokalet e Stacionit Policor në Prizren, ky fakt vërtetohet me prova materiale dhe atë me raportin për fillimin e procedurës për kundërvajtje me numër 2014-GA-0763 të datës 19.03.2014 e cila është administruar si provë në procedurë. I akuzuari në lokalet e stacionit policor ka qëndruar 10 minuta dhe pas 5 minutave të fundit ka qenë vetëm pa praninë e zyrtarit policor dhe pa vendim të ligjshëm mbi privimin nga liria. I akuzuari po ashtu theksoj se nuk ka pasur idenë se largimi nga zyra në të cilën ka qëndruar është veprë penale. Po të kisha ditur se një veprim i tillë i kryer nga ana e tij është veprë penale do të nënshtrohej rregullave dhe do të qëndronte deri sa të vijnë zyrtarët policor, kjo ka ndodhur pasi që nuk ka pas nga të informohet se veprimi i tillë është kundërligjor. I akuzuari deklaroj se shumë herë është arrestuar si aktivist i LVV por asnjëherë nuk ka tentuar që të largohet dhe të arratiset nga zyrat e policisë.

Andaj në këto rrethana pasi që ka qenë vetëm dhe pa vendim të ligjshëm nga privimi nga liria, nga aty ka dal me qëllim që ti bashkohet qytetarëve në protestë, kështu ka vepruar duke mos e menduar dhe ditur se dikush do të kërkonte arrestimin e tij për këtë gjë, pasi që lokalet e stacionit policor i ka lëshuar qetas duke ecur pa u pyetur apo penguar nga dikush. Duke e analizuar situatën e krijuar dhe tërë zhvillimin e ngjarjes, gjykata ka vlerësuar edhe raportin psikik të kryesit ndaj veprës penale. Në fakt duke e marrë parasysh se i akuzuari E.A, i takon një subjekti politik i cili veprimet e tij ka mbështetur në direktivat dhe qëndrimin e subjektit politik në fjalë dhe po ashtu duke pasur parasysh edhe moshën e re të tij, pasi që në atë kohë i akuzuari posa kishte mbushur 18 vjet, duke pasur parasysh edhe neglizhencën e zyrtarëve të policit të cilët kanë lënë vetëm në zyrë, pa vendim të ligjshëm në formë të shkruar i cili edhe pa u penguar fare largohet në lokalet e stacionit policor, në situatën e krijuar gjykata ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk ka vepruar me dashje por i njëjti për veprimet e veta ka qenë në lajthim juridik duke mos ditur se veprimi i tillë – largimi nga lokalet ku ka qëndruar është veprë penale. Pra i akuzuari nuk ka ndërmarrë veprim kundërligjor që do të ishte në pajtim me figurën e veprës penale me të cilën ngarkohet. Prandaj edhe gjykata pas administrimit dhe analizës së provave gjatë procedurës së provave këto fakte i ka vërtetuar bindshëm dhe pa asnjë dilemë në mungesë të provave gjykata e lirojë të akuzuarin nga aktakuza në pajtim me nenin 364 par.1 nën par.1.3 të KPPK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 454 par.1 të KPPK.

Nga të cekurat më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 364 par.1 nën par.1.3 të KPPK.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.622/2014 të datës 20.11.2017**

**Praktikantja**  
**Besjana Çollaku**

**Gjyqtarja**  
**Teuta Krusha**

**UDHËZIME JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e marrjes së njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.